

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 672P Rep.

Nr. 2505 Kol.



KONTRATE SHITBLERJE KUOTASH

Ne Tirane, sot me date 02/10/2006, perpara meje Noteres Dr. Soelso, me adrese ne rrugen "Vano Vash", u paraqiten personalisht personat e meposhtem per lidhjen e kesaj kontrate shitblerje kuotash te kapitalit te shoqerise:

Shitesi:

z. Shkelqim Rryta, i biri i Xhevdetit dhe Sadetes, i datelindjes 25/08/1965, lindur e banues ne Tirane, rruge "Siri Kodra", Nr.325, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me pasaporten nr.1594173;

Bleresi:

Znj. Vilma Nushi, e bija e Besnikut dhe Shpreses, e datelindjes 30/06/1961, lindur e banuese ne Tirane, rruge "Ded Gjon Luli", nr.3/1, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me pasaporten nr. 1710858.

Neni 1

- 1.1 Shitesi eshte ortak i shoqerise "HERMES" sh.p.k. me seli ne Tirane, regjistruar si person juridik me Vendimin Nr.24200 date 24/07/2000 te Gjykares se Shkalles se Rrethit Gjyqesor Tirane.
- 1.2 Shitesi zoteron 12,5 % te kuotave te kapitalit te shoqerise "Hermes" sh.p.k. me vlere 12.500 leke, si dhe kontributi ne shoqerine ne shumen 150.000 USD.
- 1.3 Keto kuota qe ai zoteron dhe kontributin e dhene, ia shet Blereses te lartpermendur e cila pranon t'i bleje ato, sipas kushteve te percaktuara me poshte ne kete kontrate.

Neni 2

- 2.1 Cmimi i shitjes se 12,5 % te kuotave te kapitalit te shoqerise "Hermes" sh.p.k. është me vleren e tyre nominale prej 12.500 (dymbedhjetemije e peseqind) leke, ndersa ai i kontributit ndaj shoqerise eshte ne vleren e saj prej 150.000 USD.
- 2.2 Nga cmimi i lartpermendur, është likuiduar nga bleresja, jashte kesaj zyre noteriale, deri ne daten e sotme shuma prej 82.000 USD dhe pjesa tjeter do t'i shlyhet ne vazhdimesi Brenda muajit tetor 2006.
- 2.3 Shitesi deklaron se e ka marre teresisht deri me sot shumen prej 82000 USD, nuk ka asnje pretendim ne lidhje me pagesen e parashikuar nga bleresja dhe jep pelqimin qe te behet kalimi i pronesise se kuotave te kapitalit tek bleresja qysh ne kete moment.

Neni 3

- 3.1 Keto kuota qe shitesi i shet blereses, i transferohen asaj ne pronesi ne daten e nenskrimit te kesaj kontrate.
- 3.2 Ne kete menyre perberja e ortakeve ne shoqerine "Hermes" sh.p.k. ndryshon dhe behet si me poshte:
- | | | |
|--------------------|---------|--|
| - Albina Mançka | zotëron | 63 % të kuotave të kapitalit themeltar |
| - Minako Koçollari | zotëron | 12.5 % të kuotave të kapitalit themeltar |
| - Vançi Deti | zotëron | 6 % të kuotave të kapitalit themeltar |
| - Pirro Braço | zotëron | 6 % të kuotave të kapitalit themeltar |
| - Vilma Nushi | zotëron | 12.5 % të kuotave të kapitalit themeltar |

Neni 4

- 4.1 Shitesi deklaron se i shet keto kuota te kapitalit te shoqerise Blereses te lira nga cdo detyrim, barre apo pretendim nga te trete.
- 4.2 Me realizimin e kesaj shitje shitesi largohet perfundimisht nga pjesmarrja si ortak ne shoqerine "Hermes" sh.p.k..

Neni 5

- 5.1 Palet deklarojne se do te zbatojne rigorozisht te gjitha te drejtat e detyrimet e tyre qe rrjedhin nga kjo kontrate.



5.2


Ne rast mosmarreveshje midis tyre ne zbatim te kesaj kontrate, palet do te bejne te gjitha perpjekjet per zgjidhjen e tyre me mirekuptim. Ne rast se nuk do te arrijne ne zgjidhje me mirekuptim, kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Kjo kontrate hartohet ne 4 (kater) kopje me te njejten vlere ligjore dhe palet pasi e lexuan dhe e gjeten ne perputhje me vullnetin e tyre te plote e te lire e nenshkruajne pa verejtje ne pamrine time. Une noteri e legalizoj sipas ligjit.

PALET KONTRAKTORE

SHITESI

SHKËLQIM RRYTA

SHKËLQIM RRYTA


BLERESI

VILMA NUSHI

Vilma Nushi


NOTER



NOTERE
Mimoza Sadushaj
TIRANE